



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 19
Prishtinë, më 25 shtator 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Të ftuar: Ahmet Tmava, kryesues, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), dhe Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatorë e Komisionit dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.09.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18.09.2013

Kryetari, konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 18 shtator 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari – Tha se Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2011 për KPMM-në, kishte rezultuar në 3 (tri) rekomandime kryesore. KPMM-ja ka adresuar vetëm një rekomandim. Raporti ka disa të gjetura si: tejkalimi i afateve ligjore për lëshimin apo shqyrtimin e licencave për hulumtim e shfrytëzim - nga 44 licencat e lëshuara për hulumtim, në 21 raste është tejkaluar afati maksimal ligjor prej 5 muajsh, dhe në 3 raste, kemi vërejtur se aplikimi për licencë ishte bërë në vitin 2009. Nga 28 licencat e lëshuara për shfrytëzim, në 19 raste është tejkaluar afati maksimal ligjor prej 4 muajsh. Lëshimi i licencës, pa kryer obligimet financiare. Në datën kur është lëshuar licenca nga KPMM-ja, kompania kishte obligime financiare në vlerë prej 36,736€. Po ashtu, ekziston edhe një transferim licence, i cili duhet të auditohet më detajisht, sepse kjo është me rëndësi për Komisionin (rasti i Drazhnjës). Edhe pse ka avancim, megjithatë borxhi total po shkon në rritje. KPMM-ja për vitin 2011, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 7,840,765€, ndërsa për vitin 2012 në vlerë prej 6,413,535€. Vlera prej 3.8 milionë është faturuar gjatë vitit 2012, ndërsa vlera tjetër prej 2.5 milionë euro është faturuar në vitet paraprake. KPMM-ja për vitin 2012, nuk kishte arritur të bëjë inventarizimin e pasurisë që ka në posedim, siç kërkohet me UA nr. 21/2009, deri më datën 13.3.2013.

Po ashtu, propozoi që ZAP-i duhet të bëjë auditim të performancës së agjencive të pavarura, sepse me auditimet e rregullsisë, nuk ka një pasqyrë të saktë për punën e këtyre institucioneve.

Afrim Hoti – KPMM-ja për vitin 2011, kishte realizuar të hyra në vlerë prej 7,840,765€. Ndërsa, për vitin 2012 në vlerë prej 6,413,535€. Vlera prej 3.8 milionë është faturuar gjatë vitit 2012, ndërsa vlera tjetër prej 2.5 milionë euro, është faturuar në vitet paraprake. Kërkoj sqarim lidhur me këtë inkasim.

Murselj Haljilji – U interesua për inventarizimin e pasurisë, ku KPMM për vitin 2012, nuk kishte arritur të bëjë inventarizimin e pasurisë që ka në posedim, ashtu siç kërkohet me UA nr.21/2009. Për çfarë arsye nuk është bërë regjistrimi i mjeteve themelore? Po ashtu në f. 19, ekziston një konstatim, sipas të cilit gjatë viti 2012, gjykatave iu kanë dërguar 19 vendime. A janë këto vendime ekzekutive dhe kur do të ekzekutohen këto? Kjo do të përmirësonte gjendjen.

Albert Kinolli – Tha se në raportin e ZAP-it, tabela nr. 2, ku flitet për shpenzimet e buxhetit, shihet se buxheti për kategorinë paga dhe mëditje është shpenzuar në vlerë prej 606,181€ apo 98%. Buxheti për kategorinë mallra dhe shërbime ishte realizuar në vlerë prej 390,594€ apo 82%. Në krahasim me vitet paraprake, vërehet trendi i uljes së shpenzimeve në këtë kategori. Buxheti për kategorinë shërbime komunale ishte shpenzuar në vlerë prej 34,816€ apo 97%. Buxheti për kategorinë investime kapitale ishte shpenzuar në vlerë prej 230,793€ apo 61%. -Pse ka ndodhur kjo dhe a do të keni planifikim më të mirë në të ardhmen?

Ramiz Lladrovci – Tha se auditimi është fokusuar në pasqyra financiare, menaxhimin dhe kontrollin e brendshëm, si dhe sistemin e auditimit të brendshëm. Si rezultat i pasqyrave financiare, të cilat prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, ZAP-i ka dhënë një opinion të pakualifikuar. Kjo do të thotë që KPMM-ja ka arritur të ndërtojë sistem të lartë të kontrollit të brendshëm dhe për këtë duhet përgëzuar. Megjithatë, vërehen dobësi lidhur me menaxhimin

financiar, llogaridhënien e menaxhmentit, si dhe menaxhimin e brendshëm. Pse nuk janë adresuar rekomandimet e vitit paraprak? Realizimi i buxhetit 84%, lë për të kuptuar që ka vend për përmirësim dhe planifikim më të mirë, e sidomos për kategoritë kapitale, ndërsa kjo duke u bazuar në 61% të realizimit të buxhetit në këtë kategori. “*Lëshimi i licencave, pa kryer obligime*”, kërkoi nga ZAP-i që në rastet kur flitet për një kompani, e cila nuk ka përmbushur obligimin dhe ka marrë licencë, të flitet me emrin e kompanisë, në mënyrë që të dihet se për cilën kompani është fjala. Pyetje për KPMM-në: Pse është lëshuar licenca e tillë? Procesi i rekrutimit për pozitën, zyrtar i lartë i prokurimit, kandidati i renditur i pari nga komisioni përzgjedhës, është tërhequr nga nënshkrimi i aktemërimit. Sipas ligjit, është dashur të thirret kandidati i dytë në listën e përzgjedhjes, por kjo nuk ka ndodhur. Pse nuk është zbatuar ligji në këtë rast?

Imri Ahmeti – Sipas ligjit, askush nuk mund të ushtrojë aktivitet pa pasur licencë të hulumtimit dhe shfrytëzimit. Është shumë shqetësues veprimi i operatorëve ilegalë në Kosovë, e numri i tyre nuk është i vogël. Cilat janë masa e ndërmarra për këta operatorë ilegalë dhe sa është numri i operatorëve legalë dhe ilegalë që veprojnë në Kosovë? Justifikimi që 28 licenca janë lëshuar mbas afatit, për shkak të moskompletimit të dokumentacionit, nuk është i bazuar në ligj. Pastaj, ku është arsyeja e rritjes së borxheve ose cilat janë masat e ndërmarra ndaj këtyre operatorëve që kanë borxhe? Ky mosefikasitet do të ndikojë që në vitin e ardhshëm borxhi të rritet. Po ashtu, dua të di nëse Bechtel - Enka ka licencë për nxjerrjen –eksproprijimin e zhavorrit në Kosovë?

Valbona Dibra – Theksoi se raporti është i rregullsisë dhe ZAP-i ka dhënë opinion të pakualifikuar, që do të thotë se pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Është ndoshta institucioni që ka më së paku të gjetura, kjo duke u bazuar në të dhënat e auditorit. Janë disa të gjetura të vogla, si regjistrimi i pasurisë me vonesë. Pse ka ndodhur që regjistrimi i pasurisë të bëhet me vonesë?

Ahmet Tmava, KPMM, Licencat - Është e vërtetë që janë dhënë licenca jashtë afateve, por kjo ka ndodhur për shkak të moskompletimit të dokumentacionit, sepse derisa ka marrë licencën e hulumtimit, nuk ka qenë i nevojshëm pëlqimi i komunës apo i ambientit dhe kur ka ardhur deri te licenca e shfrytëzimit, janë zvarritur deri te dhënia e pëlqimit të komunave. Bazuar në këtë, KPMM-ja ka dhënë një afat shtesë, kjo me qëllim të ruajtjes së investimeve që janë bërë. Jemi duke punuar që draftimi i ligjit të bëhet me qëllim të evitimit të keqpëdorimeve, kjo sidomos për rastet e transferit të licencave. *Dhënia e licencës një kompanie që nuk ka shlyer borxhet* - është fjala për “Eurokoss”. Këtë e kemi bërë me vetëdije. Kompania ka pasur aktivitetet dhe ka sjellë dëshmi milionëshe se institucionet i kanë borxh dhe kjo ka qenë arsyeja. *Miniera e Drazhnjës*-është problem kompleks. Kemi të bëjmë me një gabim të madh, sepse një aset publik i është dhënë një kompanie private. Gabimi ishte i Trepçës, sepse nuk e ka evidentuar atë minierë si aset. Kjo ka qenë në kohën kur institucionet kanë qenë të udhëhequra nga ndërkombëtarët. Kjo falë angazhimit të KPMM-së i është kthyer Trepçës si aset.

Ramiz Lladrovci – Tha se KPMM-ja nuk ka pasur të drejtë që të japë licencë, duke marrë për bazë dëshminë pse dikush i ka borxh një operatori. Kjo është në kundërshtim me ligjin. Pastaj, arsyetimi se KPMM është në konsultim me komisione parlamentare për ndryshim të ligjit, nuk qëndron, sepse përgjegjësia është e bazuar në zbatimin e ligjit që është në fuqi. Pastaj, është çështje tjetër për përkrahjen që do të bëjmë draftimit të ligjit në Kuvend.

Ahmet Tmava, KPMM – Borxhet rriten prej vitit në vit, ndërsa inkasimi ka qenë në rënie. Buxheti i vitit të kaluar ishte 6 milionë, ndërsa deri më sot, në këtë vit, janë inkasuar mbi 18

milione. Ka një vakum ligjor, sepse lëndët janë çuar në procedurë përmbartimi të dhunshëm. Kjo ka kërkuar kohë për diskutime me prokurorinë dhe gjykatat, nëse kemi të drejtë ose jo. Pastaj, kemi probleme me Ligjin për konfiskim dhe sekuestrim të pasurisë, për të cilat nevojitet vendim gjykatë. Veprimi ynë në këtë rast është komplikuar shumë. Për lëndet e proceduara në gjykatë, tani përgjegjësia është e gjykatës. KPMM-ja ka proceduar 211 lëndë në gjykatë. Ndjekja e operuesve ilegalë dhe masat kallëzuese, reflektojnë se interesi i shtetit po mbrohet. *Zgjedhja e UD të drejtorit* - ka pasur paqartësi në aspektin ligjor. Është kërkuar që MAP të shpallë konkursin. Kjo ka marrë shumë kohë për të sqaruar, nëse është konflikt interesi që MAP të bëjë përzgjedhje të një kandidati për Komision të pavarur. *Realizimi i projekteve kapitale*- në kohën kur është bërë konstituimi i institucionit, databaza është bërë nga një kompani ndërkombëtare. Na është dashur të avancojmë databazën. Kompania nuk e dorëzon kodin burimor dhe kjo ka imponuar që të shkohet me procedurë njëburimore. Në këtë rast kemi vlerësuar se nuk mund të shkojmë me procedurë njëburimore. Ishte fjala për një milion euro. Derisa të zgjidhet kjo, kemi vendosur të mos veprojmë dhe kjo ka dështuar si investim kapital. *Numri i operuesve ilegalë* dihet në bazë të kallëzimeve penale, mbi 211. *Bechtel-Enka* ka pasur 17 licenca, por ne kemi këmbngulur që duhet të paguajë rentën minerare, atëherë kjo kompani ka mbyllur licencat.

Kryetari – A keni informata se lëndët ka rrezik të parashkruhen dhe në këtë rast humbjet do të jenë të mëdha?

Ibush Jonuzi, KPMM – Çështja e operatorëve ilegalë përbën problem në vete. Nga 211 operatorë ilegalë, kapin shumën mbi 4 milionë e 500 mijë euro. Vetëm 12 kompani më të mëdha, një që kanë gjoba mbi 100.000, janë 2 milionë e treqind mijë euro etj. Por, për shkak të ndeshjes së ligjit për policinë, ligjit për KPMM dhe ligjit për konfiskim, nuk mund të veprojmë si KPMM. Vetëm Trepça ka mbi 3 milion euro, borxhe të cilat kanë do të vazhdojnë të rriten, sepse edhe pse prodhojnë nuk paguajnë. Janë 200 licenca aktive dhe 100 licenca për hulumtime, si dhe 112 licenca për aktivitete të veçanta. *Bechtel-Enka* - ka pasur 17 licenca me procedurë të shpejtuar. Me dokumentacion të plotë, por asnjëri prej tyre nuk ka kryer aktivitet. Ka vetëm një licencë të shfrytëzimit për 1 milion metër kub material. Edhe për këtë ka pasur problem, sepse duhet të paguajë rentën minerare për vlerën 1 milion euro. Na ka sjellë dëshmi se ka nënshkruar me Qeverinë kontratën, sipas së cilës nuk do të paguajë rentën për minerare, për vlerën 1 milion euro. Por, këtë duhet ta paguajë dikush, në qofte nëse ajo është Qeveria. Si rezultat i kësaj, *Bechtel-Enka* ka anuluar licencat dhe tani e ka aktive vetëm një licencë.

Ramiz Lladrovci – A do të ketë përputhje me databazën e KPMM-së për gjithë atë që *Bechtel-Enka* ka paguar taksën minerare dhe taksat tjera për të gjithë masën- zhavorrin që ka përdorur në Rugën e Kombit? *Çështja e operatorëve ilegalë* –u tha se ka operator që ka borxh mbi 300 mijë euro! Lidhur me këtë KPMM-ja është përgjegjëse, sepse operatorët ilegalë kanë operuar dhe KPMM-ja nuk ka ndërmarrë asgjë.

Haradin Gërvalla, KPMM – Regjistrimi i pasurisë- e gjtura rezulton në 61% si rezultat i projektit për avancimet e databazës. Skaneri robotik- Qeveria ka nxjerrë një instruksion me të cilin me rishikim kemi dërguar tri projekte të mjeteve, ku është përfshirë edhe skaneri robotik. Regjistrimi i pasurisë, ka qenë neglizhencë e komisionit, i cili është vonuar në procedim të raportit. Shlyerja e borxheve të vjetra- jemi duke punuar në bashkëpunim me zyrtarët e ATK-së. Jemi në proces të hartimit të Udhëzimit për trajtimin e borxheve të vjetra.

Mursel Haljilji – Lidhur me kontestet pyeti: A janë duke u zhvilluar në procedurë gjyqësore? KPMM-ja është duke zhvilluar konteste, a është ky borxh në procedurën përmbartimore e cila duhet të përmbartohet?

Ahmet Tmava, KPMM – Lidhur me zhavorrin e përdorur për Rugën e Kombit, KPMM-ja nuk ka kompetencë se me cilët operatorë ka lidhur kontratë Ministria. Nëse një kompani nuk ka përmbushur obligimet, kanë hyrë në procedurë përmbarimore, dhe si të tilla, kanë hyrë në listën e kompanive, të cilat nuk mund të marrin më licencë.

Adem Grabovci – Përmes këtij raporti janë pasqyruar të arriturat e KPMM-së. Duke ju falënderuar auditorit, marrim informata për të na paralajmëruar se kah duhet të shkojmë. Çështjet më të rëndësishme janë zgjidhur dhe i falënderoj për sqarimet e sotme, shumë të sakta. Deputetët duhet të bëjnë harmonizimin e ligjit, në mënyrë që të mos kemi probleme dhe pengesa në punën e KPMM-së. Këtë mund ta zgjidhim bashkërisht. Sa i përket çështjes së Bechtel- Enkes, duhet ta kemi parasysh që shumëçka lidhur me këtë kompani, është e rregulluar me kontratën në mes të Qeverisë dhe kësaj kompanie. Shumë lëshime që janë bërë eventualisht, janë bërë me qëllim të përfitimit në çmim, Qeveria. Përgëzoi KPMM-në që nuk ka lejuar shkeljen e ligjit. KPMM-ja ka trashëguar probleme, por me bashkëpunim dhe me rregullimin e infrastrukturës ligjore, mund të të shmangim problemet për punën e KPMM-së.

Ramiz Lladrovci – Kërkoj sqarim nga ZAP-i lidhur me skanerin robotik. Sipas raportit, thuhet se KPMM-ja ka dështuar në planifikim. Ndërsa, KPMM-ja thotë se e ka çuar atë projekt në kursim me rishikim të buxhetit.

Vlora Mehmeti, ZAP – Tha se kjo është planifikuar me buxhetin fillestar dhe KPMM-ja ka dështuar, e pastaj me rishikim është rregulluar kjo çështje.

Ibrahim Gjylderan, ZAP – Tha se në raport nuk është paraqitur emri i kompanisë e cila ka marrë licencë, pa kryer borxhet. Kjo, sepse është parim i zyrës, pasi që në objekt studimi, zyra ka institucionin dhe jo kompaninë private. Ndërsa, sa i përket çështjes së auditimit ose jo të rregullsisë, por vetëm auditim të performancës për agjencitë e pavarura, me ligj e kemi obligim të bëjmë auditimin e rregullsisë.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

- 1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, brenda afatit prej një muaji, të dorëzojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve.*
- 2. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditim të menaxhimit të licencave.*

4. Të ndryshme

Ramiz Lladrovci – Propozoi që në mbledhjet e radhës, komisioni të ketë në rend dite raportet për të cilat është dakorduar në punëtorinë në Prevallë, si: Raporti i Ministrisë së Shëndetësisë, pastaj raporti i auditimit të AKP-së, për të cilin Komisioni duhet të kërkojë që të hiqet nga rendi i ditës së mbledhjes plenare, derisa ne ta shqyrtojmë raportin e auditimit të AKP-së etj.

Valbona Dibra – Ishte kundër mendimit që raporti i AKP-së të hiqet nga rendi i ditës për shqyrtim në një mbledhje plenare, për arsye se nuk janë të bashkëngjitura raportet e auditimit. Kjo është një praktikë jo e mirë e punës së këtij Komisioni. Pastaj, secila parti politike ka përfaqësues në Kryesi, dhe në momentin kur parashihet të renditet për shqyrtim një raport,

mund të vendosin që çështja të mos renditet. Por, në këtë mënyrë, është një praktikë joprofesionale e Komisionit.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, nga 8 deputetë të pranishëm, me 6 vota për, një kundër dhe një abstenim, nxori këtë

Propozim, lidhur me amendamentimin e rendit të ditës të mbledhjes plenare të datës 26 shtator 2013

- *Të hiqet nga rendi i ditës pika e tetë “Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2012”.*
- *I njëjti raport të renditet për shqyrtim, pasi që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike të dorëzojë raportin me rekomandime lidhur me auditimin e këtij institucioni.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu